

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Afrim Qëndro i IKMT-së nuk zë mend, i jep 'Fazliçit' Ron Yeffet paradhënie 90 mijë euro për blerje makinash, si i shpëtoi burgut për aferën me Dh Albania dhe çfarë e lidh me kompanitë Ligus dhe Start Co
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/20/afrim-qendro-i-ikmt-se-nuk-ze-mend-i-jep-fazllicit-ron-yeffet-paradhenie-90-mije-euro-per-blerje-makinash-si-shpetoi-burgut-per-aferen-me-dh-albania-dhe-cfare-e-lidh-me-kompanite-ligus-dhe-start/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 16:42:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	19 shtator 2026, 22:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 19 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 20 shtator 2026, 16:42:39 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8f8c87d728613f1667e69cd26cab8318997d621359e7ae3570f5124fc0c06cce
TEKSTI	14f865a4046c956df903927146366a314454d9c3c25bbeb0e62a24264319fe07
PAMJA	d331441b251e4ead5c705f6caf48b19611afa1a9dd1642e4a57defcf0c960036

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e93d7008ef46da2297610cf214e40f8a88f40c51bb2d8f888d3d58bc9b6da58a
E MËPARSHMJA	5ed4e0a6836dd1c1b14463cba665fd67d7d0022075ffe5750502c6538524db9b
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e93d7008ef46da2297610cf214e40f8a88f40c51bb2d8f888d3d58bc9b6da58a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Afrim Qëndro i IKMT-së nuk zë mend, i jep 'Fazllicit' Ron Yeffet paradhënie 90 mijë euro për blerje makinash, si i shpëtoi burgut për aferën me Dh Albania dhe çfarë e lidh me kompanitë Ligus dhe Start Co

Investigim

Publikuar: 20/09/2026

f X



Kreu i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Afrim Qëndro, dikur polic rrugoreje në Gjirokastrë, duket se nuk ka zënë mend kur i shpëtoi për pak burgut në vitin 2018 me aferën korruptive të kompanisë së rreme të Bashkim Ulajt (DH Albania), të cilës Qendro, si kreu i ARRSH-së i dha 18 milionë euro tender për ndërtimin e lotit të parë të Unaza e Re, pa plotësuar asnjë kriter dhe me dokumente të rreme. Qëndro ishte me fat. Ai i shpëtoi burgut pasi nuk ishte ngritur ende SPAK-u. Qëndro, bashkë me Klodian Gradecin e OST dyshohet se korrumpuan prokurorit Gjergji Tako, të cilin Vetingu e çoi në riedukim, si dhe gjyqtarin Ardian Kalia, i shkarkuar si i korrumpuar.

Me të lexuarat

- Safet Gjici u rikthehet tenderave të dyshimtë pas lirimit nga burgu, në Vlorë Etjen
- Pranvera Gruda përfitoi dhjetëra mijëra euro nga buxheti i Kabinetit të trim dhe Vis Martinajn
- /Personazhi që po eliminon grupin e Canes
- Çështja e ndës
- Rreth 2 emra,... Spitalet gjermane përgatiten për luftë dhe fluks masiv pacientësh, Fletë e re t'u...
- trazon Greqinë, pas komenteve për njeriun e "Agimit të Artë"

(Ardian Kalia dhe Gjergji Tako)

Pas largimit nga kreu i ARRSH-së, Qendro u emërua nënkryetar i Bashkisë Vlorë 2020-2021, ku tentoi disa afera me tenderat dhe të dublonte Deitan Lelin, por u pengua nga ky i fundit. Në vitet 2021-2026, Qendro ka mbajtur detyrën e Prefektit të Qarkut Tiranë, ku tentoi t'i jepte tenderin e tabletave 2.3 miliardë lekë kompanisë së tij Ligus shpk, kamufluar me prestanome. Kompania Ligus ka përfituar dhjetëra milionë euro tendera, edhe nga autoritete publike ku Qëndro ka mbajtur funksione drejtuese.

Në shkurt 2026, Afrim Qëndro u emëruar në krye të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, (IKMT). Në gusht të këtij viti, Afrim Qëndro i ka dhënë 'Fazliçit' të Ramës, Ron Yeffet, në kërkim nga Afrika në Izrael për mashtrim, 90 mijë euro paradhënie për blerje makinash, duke shkelur barazinë në tendera dhe shpërdoruar detyrën. Paratë Ron Yeffet i ka përfituar përmes kompanisë TIMAK DEFENCE, me të cilën përfiton para publike pa ofruar asnjë shërbim, manipulon bilancet duke dalë me humbje, ku deri më tani dyshohet se ka zhvatur dhe fshehur në offshore rreth 30 milionë euro para publike.

Afrim Qëndro dyshohet se qëndron edhe pas kompanisë Start Co shok, e cila ka përfituar tendera publike me vlerë mbi 40 milionë euro. SPAK dhe BKH, me një hetim modest, mund të zbulojnë lidhjet e Qëndros me kompaninë Start Co, përfitimet, korrupsionin e mundshëm me tendera dhe pastrimin e parave, duke i investuar në pasuri të paluajtshme. Madje kompania Start co dhe Timak kanë marrë pjesë bashkë dhe kanë fituar tendera publike, tregues i njohjes dhe bashkëpunimit mes pronarëve në letra dhe realë të tyre.

Me kompaninë Start Co është e lidhur edhe agjencia doganore Leave & Co si dhe kompania e pjesëve të makinave Start MTE. Afrim Qëndro posedon një pasuri me vlerë qindra mijëra euro dhe pasuri të tjera të fshehura, të cilat dyshohet se janë produkt kryesisht i aferave në ARRSH, 2013-2017 tek drejtoria e projekteve dhe 2017-2019 si drejtues i ARRSH-së.

Afera me Bashkim Ulajn

Në vjeshtën e vitit 2018, ish kreu i ARRSH Afrim Qendro, ish kreu i OST Klodian Gradeci dhe oligarku Bashkim Ulaj finalizuan një aferë korruptive me vlerë 28 milionë euro përmes kompanisë false dhe fantazmë DH Albania, të kamufluar në emrin e sportelistit të Bashkim Ulajt, Avdjol Dobi.

Afera korruptive nuk ishte e zakonshme, pasi 'ustallarët shqiptarë' kishin falsifikuar letrat sikur kompania e tyre ishte dega në Shqipëri e kompanisë amerikane Dunwell Haberman. (Për këtë marifet, Ulaj ka një llogari të hapur me amerikanët). Kokat e kësaj skeme korrupsioni dhe falsifikimi, oligarku Bashkim Ulaj, Afrim Qendro që firmosi një nga tenderat 18 milionë euro dhe Klodian Gradeci i OST i shpëtuan ndëshkimit, ndoshta sepse ende nuk ishte ngritur SPAK-u.

Gradeci u arrestua në Rinas për një skemë mashtrimit 1.5 milionë USD dhe u lirua shumë shpejt, ndërsa Afrim Qendron vetëm sa u mor në pyetje si person që kishte dijeni. Dosjen për rolin e ARRSH dhe OST në skemën e korrupsionit e mbylli prokurori Gjergji Tako, në bashkëpunim me ish gjyqtarin Ardian Kalia, duke mbyllur sytë para fakteve flagrante që vishnin me përgjegjësi penale Afrim Qendron, në atë kohë kreu i ARRSH dhe Klodian Gradeci, në aty kohë kreu i OST, të cilët kishin firmosur

28 milionë euro tendera për një kompani që nuk plotësonte asnjë kriter.

Kërkesën për pushimin e çështjes e firmosi prokurori Gjergji Tako. Kërkesën e prokurorit Gjergji Tako për mbylljen e dosjes për grupin Qendro, Gradeci dhe Ulaj u pranua nga gjyqtari Ardian Kalia në 24 janar 2020. Historia u mbyll me dënimin me 6 muaj burg të sportelistit të Ulajt, Avdjol Dobi, i cili në fakt nuk bëri asnjë ditë.

TAG:

Afrim qëndro

Afrim qëndro

ARRSH afëra

Bashkim ulaj

Dh albania

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.